



ARGUMENTUM

news opinion analysis



Ndahet nga jeta Papa Françesku
Lamtumirë dhe
FALEMINDERIT!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpaket të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Lamtumirë dhe Faleminderit!

04 REDAKSIONALE

- Papa Françesku u nda nga jeta të hënën e Pashkëve, më 21 prill 2025, në moshën 88-vjeçare në rezidencën e tij në Casa Santa Marta të Vatikanit.

05 FOTOLAJM

- Bota i jep lamtumirën Papa Françeskut.

7 FOKUS

- “Jepini Çezarit, çka i përket Çezarit...”

10 OP/ED

- 200 Fjalë “Non – grata”!

13 POLITIKË

- Shefja e diplomacisë së BE-së vizitë zyrtare në Tiranë: Viti 2030, objektiv realist për integrimin e Shqipërisë.

15 JO VETEM LAJM

- Shqipëria shënon 16-vjetorin e anëtarësimit në NATO.

17 RETROSPEKTIVE DIPLOMATIKE

- 76 vjet nga themelimi i NATO-s.

19 BOTA

- Trump njofton tarifa gjithëpërfshirëse globale, duke ndezur një luftë tregtare globale.

ENGLISH EDITION

22 EDITOR'S NOTE

- Farewell and Thank You!

23 REALPOLITIK

- Only praises and prolises for Meloni! Facts versus untruths! Immediate ceasefire and genuine peace, no deal for new occupation! Back after 60 years!

25 OP/ED

- Diplomacy, State-Building, and Memory: Germany's role in Kosovo through a scholarly lens.

27 IN FOCUS

- The Serbo-Russian Nexus in Hybrid Warfare. Why are Telegram channels dangerous for nation security?

29 GLOBAL

- Türkiye's political future following the arrest of İmamoğlu.



Lamtumirë dhe Faleminderit!

Faleminderit Papa Françesku, që zgjodhe Shqipërinë si vendin e parë që do të bekoje me vizitën tënde pas emërimit si Papë. Erdhe dhe dëshmove dashurinë e këtij populli të vuajtur, i cili, edhe në kohët më të errëta, nuk e harroi kurrë dashurinë për Zotin. Erdhe, i bekove dhe u lute për dhjetëra martirë që dhanë jetën në emër të ZOTIT. Erdhe dhe preke me zemër harmoninë tonë fetare – atë që ti vetë e quajte “vëllazëri fetare”.

Faleminderit Papa ynë, që shkele mbi këtë tokë të varfër, por të pasur në shpirt dhe bujari. Kjo vizitë u bë gjithashtu simbol i rrugëtimit tënd përkrah të varfërve, të harruarve, të pamundurve. Ishe zëri i atyre që nuk kishin zë.

Faleminderit Papa i shenjtë, që nuk u nënshtrove para shteteve të mëdha dhe që denove me zë të lartë vrasjen e mijëra fëmijëve në Gaza. Ishe i vetmi që e quajte këtë luftë një genocid... Nuk ndale kurrë së

luturi për ta – madje edhe të dielën e Pashkëve, pak orë para se të shkoje pranë Zotit.

Faleminderit që dënuat çdo luftë dhe çdo formë padrejtësie. Mbi të gjitha, faleminderit që ngritët zërin kundër thirrjeve për armatim — madje edhe në mesazhin tuaj të fundit Urbi et Orbi, ku theksuat sërish: jo garës së armatimeve, jo më jehonës së vdekjes. Ju thirrët për paqe, për dialog, për bashkëjetesë.

Faleminderit që edhe me largimin tuaj nga kjo jetë arritët të bashkoni mbarë botën — nga Lindja në Perëndim, nga Europa në Amerikë, e deri në Azi. Tani mund të preheni i qetë pranë Atit, në paqe dhe dritë të përvetshme. Misioni juaj në tokë u përm-bush!

Faleminderit që ishe mes nesh. Do të mbetesh gjithmonë, bariu ynë i mirë.

Faleminderit që ishe Papa i popullit!

Papa Françesku u nda nga jeta të hënën e Pashkëve, më 21 prill 2025, në moshën 88-vjeçare në rezidencën e tij në Casa Santa Marta të Vatikanit



Në orën 9:45 të mëngjesit, Kardinali Kevin Farrell, Camerlengo i Kishës së Shenjtë Romake, njoftoi vdekjen e Papa Françeskut nga Casa Santa Marta me këto fjalë:

“Vëllezër dhe motra më të dashur, me dhimbje të thellë më duhet të njoftoj vdekjen e Atit tonë të Shenjtë Françesku. Në orën 7:35 të mëngjesit të sotëm, peshkopi i Romës, Françesku, u kthye në shtëpinë e Atit. E gjithë jeta e tij iu kushtua shërbimit të Zotit dhe Kishës së Tij. Ai na mësoi të jetojmë vlerat e Ungjillit me besnikëri, më të përzemërt, me dashurinë më të pëlqyer. Me mirënjohje të pamasë për shembullin e tij si dishepull i vërtetë i Zotit Jezus, ne e përgëzojmë shpirtin e Papa Françeskut në dashurinë e pafundme të mëshirshme të Zotit Një dhe Triuni.”

Drejtori i Zyrës së Shtypit të Se-

lisë së Shenjtë, Matteo Bruni, u tha gazetarëve më vonë të hënën se trupi i Papës së ndjerë mund të transferohej në Bazilikën e Shën Pjetrit të mërkurën në mëngjes, në mënyrë që besimtarët të mund të luten para eshtrave të tij mortore. “Përkthimi i mbetjeve mortore të Atit të Shenjtë në Bazilikën e Vatikanit, për nderim të të gjithë besimtarëve, mund të bëhet mëngjesin e së mërkurës, 23 prill 2025, sipas rregullimeve që do të përcaktohen dhe do të komunikohen nesër, pas Kongregatës së parë të Kardinalëve”, tha zoti Bruni.

Papa i parë argjentinas në historinë e Kishës trajtoi shumë tema, veçanërisht në lidhje me kujdesin e tij për të varfrit, vëllazërinë, kujdesin për shtëpinë tonë të përbashkët dhe “jo”-në e tij të vendosur dhe të pakushtëzuar ndaj luftës.




Papa i parë argjentinas në historinë e Kishës trajtoi shumë tema, veçanërisht në lidhje me kujdesin e tij për të varfrit, vëllazërinë, kujdesin për shtëpinë tonë të përbashkët dhe “jo”-në e tij të vendosur dhe të pakushtëzuar ndaj luftës.

Por zemra e mesazhit të tij, ajo që padyshim pati ndikimin më të madh, ishte thirrja e tij ungjillore për mëshirë, që është pikërisht afërsia dhe butësia e Zotit ndaj atyre që e njohin nevojën e tyre për ndihmën e Tij.

Mëshira, tha ai, është “ajri që thithim”, që do të thotë se është ajo që na nevojitet më shumë, pa të cilën do të ishte e pamundur të jetojmë.


BOTA I JEP LAMTUMIRËN PAPA FRANÇESKUT

Rreth 250,000 persona nga mbarë bota u mblodhën më 26 prill në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan për të marrë pjesë në meshën mortore të Papa Françeskut. Ceremonia, që zgjati 90 minuta, mbledhi së bashku krerë shtetesh, anëtarë të familjeve mbretërore dhe personalitete të larta, të cilët i dhanë lamtumirën e fundit Papës.





“Jepini Çezarit, çka i përket Çezarit...”



Ky citat i njohur biblik gjen sot një rezonancë të veçantë në realitetin politik shqiptar, veçanërisht në figurën e liderit historik të Partisë Demokratike, z. Sali Berisha. Pas një periudhe të gjatë betejash të vështira – jo vetëm me drejtësinë dhe barrën e rëndë të shpalljes “non grata” nga SHBA, por edhe me ndjenjën e tradhtisë brenda vetë partisë që ai themeloi dhe drejtoi për dekada, ky rikthim është më shumë se një betejë politike.

Kur Sali Berisha deklaroi tërheqjen e tij nga skena aktive politike pas humbjes në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013, askush nuk do të mendonte se, pikërisht ai, që dha dorëheqjen bindshëm, do të kthehej pas 12 vitesh, madje më i bindur dhe më i vendosur për të rikthyer pushtetin dhe për të sjellë një

rrotacion politik në Shqipëri. Ndërsa Sali Berisha ngjitet në podiumin e sheshit “Nënë Tereza” për fushatën e tij elektorale përpara zgjedhjeve të 11 majit, është e pamundur të mos vihet re forca, energjia, bindja dhe qëndrueshmëria që ai transmeton përpara mijëra mbështetësve. I gatshëm për të nisur një betejë të re politike, Berisha – tashmë 81 vjeç – nuk ndalet.

Z. Berisha vërtetë kaloi përmes përjashtimesh dhe ndarjesh brenda familjes së tij politike por mbështetja e fuqishme që ai ka sot nga një pjesë e madhe e demokratëve tregon se, për shumëkënd, ai mbetet ende simbol i frymës dhe identitetit të Partisë Demokratike. Ky nuk është thjesht një rikthim në politikë, por një ringritje ndaj padrejtësive që, sipas tij dhe mbështetësve të tij, janë shka-

ktuar në emër të interesave të ngushta nga kundërshtari i tij politik.

Por përtej këtij katër vjeçari jo të lehtë për z.Berisha, historia politike e tij dëshmoi edhe një herë se figura të tilla nuk zhbëhen lehtë. Berisha nuk zgjodhi të heshtë. Ai u rikthye në garë, u përball me akuzat, mori mbështetjen e një pjese të madhe të anëtarësisë, dhe sot kërkon të marrë sërish drejtimin e vendit. Ky rikthim nuk është thjesht një përplasje mes figurash apo një luftë për poste. Është një përballje për legjitimitet, për identitetin e së djathtës, dhe për të drejtën që ai kërkon si themelues, udhëheqës dhe simbol i një epoke pluraliste në politikën shqiptare. Nga ana tjetër kemi Lulzim Bashën, i cili ndërmori vendimin për të distancuar veten nga ish-kryetari i PD-së pas shpalljes

“non grata” të tij nga SHBA. Basha e përjashtoi Berishën nga partia, një akt që u cilësua si tradhti nga shumë demokratë. Ky veprim solli përçarje të thellë brenda PD-së, duke krijuar një ndasi të fortë mes anëtarësisë dhe duke ndikuar negativisht në forcën e opozitës.

Pavarësisht se Basha u gjend përballë një furie të madhe dhe të justifikuar të elektoratit demokrat, ai nuk mori përgjegjësinë për të dalë dhe për t'u përballur me ta. Në vend që të shpjegonte arsyet e tij për vendimin e ndërmarrë, ishte vetë z. Berisha ai që ndërmori një tur në çdo qytet të Shqipërisë, nga veriu në jug, për të folur drejtpërdrejt me demokratët dhe qytetarët. Në çdo takim, ai shpjegoi arsyet pse e konsideronte largimin e tij si një puç, jo vetëm ndaj tij personalisht, por ndaj vetë Partisë Demokratike dhe demokracisë shqiptare. Ai e paraqiti këtë proces si të ndikuar nga faktorë të jashtëm dhe interesa që synonin të dobësonin opozitën.

Ky tur i tij u kthye në një mobilizim të fortë politik dhe emocional për shumë demokratë. Mbështetja e bazës në terren, rikthimi në qendër të debatit publik dhe organizimi i strukturave të reja i dhanë një hov të ri levizjes që ai e udhëhoqi drejt ringritjes së tij dhe këtij rikthimi në krye të Partisë Demokratike dhe betejës për pushtet.

Pavarësisht se kaloi gati një vit nën arrest shtëpie, z. Berisha arriti të mbante gjallë elektoratin demokrat dhe qytetarët shqiptarë. Ai krijoi, një miting të përditshëm që mbante aktiv mbështetësit e tij. Kjo forcë e cila mund të dukej e pamundur për shkak të moshës biologjike



të z. Berisha, është një pasqyrim i vendosmërisë së tij për të çuar përpara atë që ai e konsideron një puç të organizuar kundër tij, një padrejtësi e orkestruar nga George Soros dhe qeveria në pushtet, për të eliminuar opozitën shqiptare.

Le ti rikthehemi vendimit “non grata” ndaj Berishës nga SHBA. Kujtojmë se Sali Berisha, ish-kryeministër i Shqipërisë dhe lider i Partisë Demokratike, u shpall “non grata” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 19 maj 2021, për shkak të akuzave për korrupsion që, sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, dëmtonin demokracinë në Shqipëri. Ky vendim erdhi pak pasi Edi Rama mori mandatin e tij të tretë në zgjedhjet parlamentare. Vendimi ishte i papritur, duke pasur parasysh faktin se

Berisha nuk ishte më në krye të Partisë Demokratike, por vazhonte të ishte deputet i Parlamentit shqiptar, i tërhequr nga politika aktive.

Sigurisht, jetëgjatësia politike e zotit Berisha si president dhe kryeministër e Shqipërisë ka dritë-hijet e saj. Në këndvështrimin tim, vitet e para të pluralizmit ishin jashtëzakonisht të vështira për vendin, jo vetëm për shkak të hapjes përballë ndryshimeve pas rënies së komunizmit, por edhe për keqmenaxhimin politik dhe qeverisjen e dobët që çoi në krizë të njëpasnjëshme, nga kriza ekonomike te ngjarjet tragjike si kriza e firmave piramidale dhe lufta civile e vitit 1997. Në këtë kontekst, dy momente të errëta të Shqipërisë pas komunizmit i atribuohen zotit Berisha si funksionari më



Rikthimi i Berishës është më shumë një çështje morale. Ai e mori përsëri në dorë Partinë Demokratike, i riktheu figurat që ishin përjashtuar nga kryetari, Lulzim Basha, dhe duket se ka konsoliduar bazën e partisë, sigurisht me besnikët e tij në krye. Ndonëse kriza që pësoi Partia Demokratike pas vitit 2021 solli krijimin e dy partive të reja, që dalin si degë të Partisë Demokratike, dhe kjo do të dobësojë dhe fragmentojë votën e elektoratit demokrat në këto zgjedhje.

i lartë i shtetit.

Megjithatë, edhe kur ai ishte në opozitë, nga viti 1997 deri në vitin 2005, nuk pati asnjë vendim “non grata” nga SHBA për Berishën. Në fakt, nëse Berisha kishte apo jo përgjegjësi për shkatërrimin e vendit gjatë periudhës 1995-1998 dhe krizat që përmenda, këto çështje janë çështje që i takojnë drejtësisë dhe, po ashtu, SHBA-së. Kjo sepse Berisha ishte aleat i rëndësishëm i SHBA-së në Shqipëri.

Fakti që ai arriti të kthehej në pushtet në vitin 2005 është, për mua, një formë amnistie që SHBA-ja bëri ndaj Berishës për krizën e mëparshme dhe periudhën e kaluar nën qeverisjen e tij. Periudha e dytë e qeverisjes së Shqipërisë nga Partia Demokratike, me në krye z. Sali Berisha, ka padyshim arritjet e veta. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria mori statusin e Asocim- Stabilizimit, u anëtarësua në NATO, priti presidentin amerikan George Bush, i cili nga Tirana shpalli hapur mbështetje për pavarësinë e Kosovës. U liberalizuan vizat dhe pati një rritje të investimeve në infrastrukturë, etj.

Megjithatë, ka edhe dy momente që e shënojnë negativisht këtë qeverisje tetëvjeçare të Berishës. Njëra është tragjedia e 15

marsit në Gërdec, ku ende nuk janë vënë para drejtësisë ata që mbajnë përgjegjësi për këtë ngjarje tragjike. Po ashtu, një tjetër moment i rëndë ishte protesta e 21 janarit 2011, ku fatkeqësisht humbën jetën katër protestues. Kjo protestë u thirr nga opozita socialiste, për shkak të aferës korruptive ku akuzohej z. Ilir Meta që ishte në koalicion bashkëqeverisje me z. Berisha.

Por dhe kjo protestë e 21 janarit 2011 u sfumua, duke pasur parasysh se Ilir Meta u rikthye në koalicion me Edi Ramën, duke e bërë që Rama ta “amnistonte” Metën. Ai harroi protestën që kishte thirrur vetë, dhe më vonë, si kryeministër, Rama shpalli “dëshmorë” katër protestuesit. Sigurisht, familjeve të tyre iu dha një kompensim financiar, ndërkohë që çdo 21 janar i fton ata në kryeministri, hedh karafila në vendin ku ata u vranë në bulevard dhe i përcjell me një kafe e premtime se drejtësia do të shkojë në vend.

Pra, parë në retrospektivë, këto mosmarrëveshje politike, veprimet dhe manovrat që janë ndërmarrë gjatë qeverisjes së Z. Berisha tregojnë se Sali Berisha ka përfituar një formë ‘amnistie’ si nga SHBA-të, ashtu edhe nga Partia Socialiste.

Ndaj sa i përket vendimit të 19 majit 2021 nga Departamenti amerikan i shtetit ku Berisha shpallej “non grata” pas largimit të tij nga pozitat kryesore të Partisë Demokratike dhe pas daljes nga politika aktive, ku ai nuk kishte më një rol të drejtpërdrejtë në qeverisjen e vendit duket si një masë që, në fakt, nuk kishte më efekt të drejtpërdrejtë në jetën politike të Shqipërisë. Kjo shpallje “non grata” u duk më shumë si një masë ndëshkuese e pavlerë, duke marrë parasysh pra se Berisha tashmë nuk ishte në vijën e parë të politikës.

Ndaj, ky rikthim i Berishës është më shumë një çështje morale. Ai e mori përsëri në dorë Partinë Demokratike, i riktheu figurat që ishin përjashtuar nga kryetari, Lulzim Basha, dhe duket se ka konsoliduar bazën e partisë, sigurisht me besnikët e tij në krye. Ndonëse kriza që pësoi Partia Demokratike pas vitit 2021 solli krijimin e dy partive të reja, që dalin si degë të Partisë Demokratike, dhe kjo do të dobësojë dhe fragmentojë votën e elektoratit demokrat në këto zgjedhje. Por duhet theksuar se Berisha, pavarësisht këtyre sfidave, doli më i fortë.

A do të fitojë Berisha në 11 maj, kjo mbetet për t'u parë, por ai ka fituar tashmë shumë në aspektin politik. Një zotëri 81-vjeçar, duket se është i aftë të bëjë për vete, të bashkojë dhe të riorganizojë elektoratin demokrat, duke i dhënë besim dhe shpresë, si një lider i vërtetë. Liderhipi i Berishës, qëndrueshmëria dhe forca e tij janë ato që i takojnë këtij “Çezari”, që ka mbajtur një rol të rëndësishëm në politikën shqiptare për tre dekada.

200 Fjalë “Non – grata”!



DR. JORGJI KOTE

Mjeshtër i Madh

Padyshim që në këto 8 dekadat e fundit, SHBA-të e kanë treguar vehten si komb i jashtëzakonshëm, me një politikë të brendshme dhe të jashtme të karakterizuar nga etika, idealizmi dhe Realpolitika. Duke realizuar kësisoj vizionin e Thomas Jeffersonit që “SHBA-të të jenë shpresa më e mirë në botë” apo «një far ndriçues mbi kodrinë» siç u shpreh Regani në fjalën e vet të lamtumirës presidenciale”.

Mirëpo tani, siç pohon me dhimbje Ed Arnold, Bashkëpunëtor i Lartë Kërkimor në Institutin Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara në Londër ” dhe shumë ekspertë të tjerë duket se SHBA-të po ndahen me vlerat perendimore”.

Në politikën e tanishme të brendshme vlerësohen disa aspekte pozitive, sidomos mbrojtja e vlerave tradicionale konservatore, shkurtime burokratike, lufta kundër shpërdorimeve dhe abuzimeve, forcimin e kohezi-

onit social, etj. Mirëpo, krahas tyre po shihen akte, veprime dhe sulme të paprincipita kundër vlerave dhe institucioneve më përfaqësuese të demokracisë amerikane dhe perendimore.

”Revolucioni i Madh Kulturor” amerikan, siç e quajnë disa analistë perendimorë ka përfshirë fushat më jetike, si arsimin, kulturën, shëndetësinë, gjyqësorin, shtypin, median, duke i shpallur luftë të hapur elitës intelektuale, shkencore, kulturore dhe media-tike amerikane dhe të huaj.

Kështu, në mesnatën e 14/15 Marsit iu ”vu dryni me një të rënë të lapsit” emblematikës ” Zëri i Amerikës” dhe Radio Free Europe/Radio Liberty – të krijuara në vitet 40 për t’u treguar të vërtetën popujve që vuanin në zgjedhën totalitare nazi-fashiste dhe mbas vitit 1945 – 1990 dhe atyre që vuanin në totalitarizmin e kuq. Pa konsultime as me Kongresin që e financon atë. Ndonëse kostoja vjetore prej vetëm 270 milion Dollarë me 2000 gazetarë

në 60 gjuhë të botës dhe me mbi 400 milionë ndjekës nuk ishte ndonjë gjë për një vend të madh si SHBA-të. Ndaj dhe « vdekja » e VoA-s u festua me shampanjë në vendet me rregjime diktatoriale. Me të drejtë në 8 paditë gjyqësore nga federatat mediatike, gazetarët dhe drejtori i Përgjithshëm i VoA-s, në Letrën e 41 kongresmeneve drejtuar Presidentit Trump dhe në reagimet e shumta kudo në botë theksohet se « ajo që po ndodh me gazetarët e VoA-s është jo vetëm shkelje e Amendamentit të Parë Kushtetues për lirinë e fjalës/shtypit, por dhe mbyllja qeveritare e gazetarisë; mbyllje e cila minon « fuqinë e butë » dhe besueshmërinë e politikës dhe imazhit amerikan kudo në botë» E njëjta gjë mund të thuhet për mbylljen dhe pas anulimit gjyqësor riformatimin total të US-AIDI-t të krijuar nga Presidenti John F. Kennedy për të përmirësuar kushtet social-ekonomike në vendet që vuajnë nga rreg-

jimet autoritare dhe terrorizmi. Po ashtu, « Fabrika e mendimit » siç njihet Think Tanku me shtrirje ndërkombëtare « National Endowment for Democracy », i krijuar nga Presidenti Regan ushtronte kudo shumë forma të larmishme pune dhe jepte bursa studimi për aktivistët e demokracisë dhe politikanët e rinj në gjithë botën.

Kësaj furtune kësaj radhe nuk po i shpëtojnë dot as universitetet me famë botërore, si Harvard, Columbia dhe Yale, të cilave si ndëshkim po u shkurtohen 1/3 e fondeve qeveritare, dmth miliarda dollarë në fushën kërkimore. Për pasojë, sipas një sondazhi në fillim të kësaj jave me 1608 shkencëtarë, rezultoi se 2/3 e tyre do të largohen nga vendi për në Europë. Ky proces ka filluar në masë, duke filluar me largimin e tre historianëve më të mirë amerikanë, çiftit Timothy Snyder & Marci Shore dhe Jason Stanley.

Këtu po ndalemi posaçërisht te fakti se fushatës së tanishme qeveritare në Uashington nuk i ka shpëtuar dot as gjuha dhe komunikimi zyrtar dhe njerëzor. Konkretisht, një ndër dekretet e para të Presidentit Trump ishte ndalimi kategorik i përdorimit të një « liste të kuqe » me plot 200 fjalë – koncepte themelore të jetës në të gjitha fushat, e ngjashme me personat « non – grata ». Sipas ekspertëve përkatës, kjo « embargo » e re synon që në vendin më të shquar demokratik

të botës të ketë më pak tolerancë fjale dhe më shumë hapësirë për diskriminim!

Në këtë grup fjalësh « non-grata » ka shumë fjalë kyç, të cilat lidhen me nivelet e arritura të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të lirive themelore të njeriut, të mishëruara në kon-



ventat ndërkombëtare dhe në Kartën Universale të OKB-së. Ato janë tregues të pjekurisë së demokracisë liberale, tematikave dhe shqetësimeve që ajo ka patur; të cilat janë zgjidhur jo me kufizime dhe ndalime, por me diskutime dhe konsultime të vazhdueshme mes vendeve dhe autoriteteve përkatëse.

Për t'ia lehtësuar punën lexuesve dhe ndjekësve tanë të nderuar, po ndalemi me komente fare shkurt të grup fjalëve kryesore që tashmë janë « non -grata ».

« Lista e kuqe » përfshin fjalën « KLIMA » me shoqërueset e saj, kriza e klimës, shkenca e klimës dhe cilësia e klimës“. Kjo

nuk është rastësore, sepse dihet tashmë se SHBA e Trump u larguan nga Marrëveshja e Klimës e Parisit e vitit 2015 dhe tani sërish kanë shprehur kundërshtimin ndaj masave dhe reformave të klimës, ku SHBA-të janë kontribuesi kryesor i ndotjes së saj. Për pasojë, edhe « ndotje » dhe « energji e pastër » janë në Listën e Kuqe të ndaluar.

Fjala « IDENTITET » me kombinimet e saj – identiteti dhe ideologjia gjinore, seksuale, racore... » DIVERSITET » Edhe pse në Gjermani dhe në Europë në përgjithësi, por dhe në SHBA deri tani thuhej se « diversiteti është pasuri » ashtu sikurse flitet kudo për « unitet në diversitet »

ndryshe nga « uniteti i çeliktë » në totalitarizëm. Mirëpo ja që ndryshe mendon tani « America first ». Duke e ndaluar këtë fjalë dhe kombinimet e saj të mundshme; « sfondi divers, grupe dhe komuniteti diversiteti, promovimi i diversitetit, diversiteti racial, diversiteti gjinor... »

Ashtu siç edhe pritej, « Non – grata » janë LGBT&LGBTQ, femrat, feminizmi si dhe fjalët « seksi, preferencat/orientimet seksuale, trasngjinore, transeksuale. Por me të drejtë nuk lejohen të përdoren fjalët « person(a) njerëz shtatzënë » si tepërime të palejueshme dhe pa asnjë logjikë.

Fjala RACA dhe RACIAL është ndër « viktimat » e tjera të mëdha me një gamë të gjerë përdorimesh, si diversiteti racial,



Këtu po ndalemi posaçërisht te fakti se fushatës së tanishme qeveritare në Uashington nuk i ka shpëtuar dot as gjuha dhe komunikimi zyrtar dhe njerëzor. Konkretisht, një ndër dekretet e para të Presidentit Trump ishte ndalimi kategorik i përdorimit të një « liste të kuqe » me plot 200 fjalë – koncepte themelore të jetës në të gjitha fushat, e ngjashme me personat « non – grata ». Sipas ekspertëve përkatës, kjo « embargo » e re synon që në vendin më të shquar demokratik të botës të ketë më pak tolerancë fjale dhe më shumë hapësirë për diskriminim!

pabarazia raciale dhe drejtësia raciale.

Fjala SOCIALE është gjithashtu e ndaluar në disa kombinime. Psh socio – ekonomik, socio-kulturor, drejtësia sociale, si dhe fjalët të Nënveftësuar, të Nënprivilegjuar, Gra të nënprerfaqësuar, Grupe te marginalizuara, pakicat, pakicat hispanike, popullsia vulnerabel ose e rrezikuar dhe shëndeti mendor. Kjo shpjegohet me pretendimin e ideologëve ekstremistë amerikanë se në MAGA-N amerikanë tash e tutje nuk ka nga këto grupe popullsie dhe shoqërore, se ato i takojnë të kaluarës amerikanë, dhe elitës së korruptuar të majtë europiane.!! Ndaj për to nuk ka vend as në fjalorin e përditshëm dhe ca më pak në atë zyrtar!

Dhe lista vazhdon çuditërisht me ndalimin e termit « Gjuha e urrejtjes » që të paktën deri tani ka qenë dhe mbetet problem shqetësues në SHBA dhe në Europë.

Akoma më e pakuptueshme është ndalimi i fjalës/koncept « Ndjenja e përkaëtsisë (sense of belonging) një nga faktorët më vendimtarë në jetën e njeriut, krahas pozitivitetit, marrjes së

vendimit dhe vizionit për jetën.

Në përfundim, është vërtetë diçka e rëndë dhe e vështirë kur mendon se kjo dukuri e çuditshme po ndodh në një vend që deri tani ka qenë historikisht kampion i demokracisë, i shtetit të së drejtës, i shumë nismave, programeve dhe konventave ndërkombëtare në këto fusha, duke ëprfshirë dhe gjuhën dhe komunikimin njerëzor; ku dhe ne shqiptarët, përfshirë dhe autorin e këtyre radhëve kemi mësuar shumë në 35 vitet e fundit. Mbasi dihet se shumica e këtyre koncepteve dhe praktikave te ne përpara viteve 90 ishin të ndaluara ligjërisht. Por ama « non – gara » nuk ishin, se jam vetë dëshimtar i asaj kohe, siç po ndodh tani në Uashington, madje kjo vështirë të ishte menduar dhe nga skeptikët më të mëdhenj.

Në përfundim, thjesht nga ana praktike dhe gjuhësore, meqenëse kjo e fundit i përket dhe kualifikimit dhe zanatit tim të parë, imagjinoni po t'u tekej të bënin të njëjtë gjë dhe vendet e tjera sa herë ndërroheshin kryetarët e shtetit/qeverive! Do të krijohet një trafik kaotik i paparë gjuhë-

sor dhe komunikimi çka do të çonte dhe në përplasje të ashpra politike, ideologjike, sociale, ekonomike dhe praktike mes shteteve dhe popujve; dhe nuk do të kishte as polici gjuhësore dhe as një polici tjetër në botë që do ta zgjidhte lëmshin që do të krijohej.

Së fundi, kujdes, se këtu nuk bëhet fjalë për dëshira fakultative, nëse të pëlqen apo jo të përdorësh një apo disa fjalë të caktuara, por për ligje dhe dekrete presidenciale, të cilat të detyrojnë dhe të dënojnë nëse i shkel ato, sidomos në dokumentet dhe aktet zyrtare, në kërkesat për vende pune dhe prokurime publike, ku do të « digjet » kushdo që përdorë qoftë dhe një fjalë « non – grata » në formularët përkatës. Akoma më e ndërlikuar do të bëhet kur të vijë puna dhe në marrëdhëniet me jashtë!

« Viktima » e parë e fjalëve « non -grata » u bë një gazetar i Reutersit emblemantik, të cilit iu ndalua prania e mëtejshme në konferencat e shtypit në Shtëpinë e Bardhë, se përdori termin « Gjiri i Meksikës » siç e quan gjithë bota në 4 shekujt e fundit; të cilin Trump e kishte shpallur 2 ditë më parë si « Gjiri i Amerikës »!

SHEFJA E DIPLOMACISË SË BE-SË VIZITË ZYRTARE NË TIRANË:

Viti 2030, objektiv realist për integrimin e Shqipërisë



Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Bashkimit European, Kaja Kallas zhvilloi sot një vizitë zyrtare në Tiranë.

Kallas u prit në një takim në Kryeministri nga Kryeministri Edi Rama. Në këtë takim Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Bashkimit European shoqërohej nga ambasadori i Delegacionit të BE-së në Tiranë, Silvio Gonzato.

Për palën shqiptare në takim ishin të pranishëm po ashtu zv/kryeministrja Belinda Balluku, njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani si dhe ministrja e Shtetit dhe Kryenegociatorja e

Shqipërisë me Bashkimin Evropian, Majlinda Dhuka.

Përveç takimeve me zyrtarët e lartë të vendit, Kallas do të marrë pjesë në forumin e dialogut Shqipëri-BE për politikën e sigurinë dhe më pas në ceremoninë e marrëveshjes me Bankën Europiane të Investimeve.

Rama: Shqipëria, 100% e linjësuar me politikën e jashtme të BE-së

Kryeministri Edi Rama deklaroi sot se Shqipëria është 100% e linjësuar me politikën e jashtme të Bashkimit European, ndërsa solli në vëmendje edhe kalendarin shumë ambicioz të dakordësuar me Komisionin European për mbylljen e negociatave për

anëtarësim brenda vitit 2027.

Në një konferencë të përbashkët për shtyp me Përfaqësuesen e Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Bashkimit European, Kaja Kallas, Kryeministri vlerësoi se mes Shqipërisë dhe Bashkimit European nuk ka asnjë çështje të hapur.

“Kemi pasur një takim si gjithmonë shumë pozitiv. Ashtu siç tha edhe Presidentja mes nesh dhe BE-së nuk ka asnjë problem apo çështje të hapur. Përkundrazi, kemi një linjëzim të plotë në të gjitha aspektet, gjë që shprehet më së miri edhe në politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë e cila është 100% e linjësuar me politikën e jashtme të BE-së”, tha Rama.

Kryeministri informoi se pjesë e bisedës me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së është sfida e madhe e procesit drejt anëtarësimit në BE, si dhe kalendari shumë ambicioz i dakordësuar me Komisionin për mbylljen e negociatave brenda vitit 2027.

Po ashtu, Rama tha se temë e bisedës ishte edhe rajoni dhe problematikat në rajon, në një moment kur ne kemi të domosdoshëm unitetin dhe stabilitetin e të gjithë rajonit.

“Fatmirësisht të gjitha vendet kanë synim të shpallur strategjik anëtarësimin me BE dhe ky destinacion është një pikë referimi jashtëzakonisht e dobishme dhe ndihmuese për të kuptuar edhe politikën e ditës dhe hapat që të gjithë së bashku duhet të hedhim në të përditshmen tonë, në mënyrë që jo thjesht secili prej nesh të anëtarësohet në BE, por gjithë ky rajon të bëhet pjesë organike e familjes së bashkuar europiane”, shtoi Rama.



Kallas: Viti 2030, objektiv realist për integrimin e Shqipërisë
Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas u shpreh sot gjatë konferencës së shtyp me Kryeministrin Edi Rama në Tiranë se objektivi për

“Fatmirësisht të gjitha vendet kanë synim të shpallur strategjik anëtarësimin me BE dhe ky destinacion është një pikë referimi jashtëzakonisht e dobishme dhe ndihmuese për të kuptuar edhe politikën e ditës dhe hapat që të gjithë së bashku duhet të hedhim në të përditshmen tonë, në mënyrë që jo thjesht secili prej nesh të anëtarësohet në BE, por gjithë ky rajon të bëhet pjesë organike e familjes së bashkuar europiane”.

integrimin e Shqipërisë në familjen evropiane deri në vitin 2030 është një objektiv realist, por që bazohet në shtetin e së drejtës dhe kushtëzohet nga fakti nëse të dyja palët gjatë këtij rrugëtimi bëjnë mirë “detyrat e shtëpisë”.

Duke iu përgjigjur interesimit të medias nëse kushtëzohet integrimi i Shqipërisë në BE nga reforma të caktuara, një prej tyre ajo e ndjekjes së korrupsionit ndaj zyrtarëve të lartë, Kallas tha se “viti 2030 është një objektiv realist, në rast se ne të gjithë do të ndërmarrim hapat e duhur gjatë rrugës. Por, jo vetëm reformat që duhen miratuar, por edhe reformat e miratuara që duhen të vihen në zbatim”.

“Dhe sundimi i ligjit është shkajshmërisht i rëndësishëm, pasi shteti i së drejtës është një nga themelet e BE, por edhe themeli i begatisë së një vendi sepse në rast se investuesit kanë besim te sistemi juaj ligjor ata kanë besim të investojnë në ekonominë tuaj. Kjo është në të mirën e Shqipërisë, është realiste në rast se të gjithë bëjmë detyrat e shtëpisë”, tha Kallas.

“Dhe sundimi i ligjit është shkajshmërisht i rëndësishëm, pasi shteti i së drejtës është një nga themelet e BE, por edhe themeli i begatisë së një vendi sepse në rast se investuesit kanë besim te sistemi juaj ligjor ata kanë besim të investojnë në ekonominë tuaj. Kjo është në të mirën e Shqipërisë, është realiste në rast se të gjithë bëjmë detyrat e shtëpisë”.



Shqipëria shënon 16-vjetorin e anëtarësimit në NATO

Shqipëria u bë anëtare e NATO-s më 1 prill 2009, një moment historik për vendin dhe për popullin shqiptar. Ky ishte një angazhim i rëndësishëm për stabilitetin, sigurinë dhe integritimin e vendit në strukturat euroatlantike. Pas një periudhe të gjatë reformash dhe angazhimi për përmbushjen e standardeve të NATO-s, Shqipëria arriti të bëhej pjesë e kësaj aleance ushtarake, që është një nga arritjet më të mëdha të politikës së jashtme të vendit në dekadat e fundit.

Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO ka nisur që pas vitit 1999, pas mbarimit të Luftës në Kosovë dhe fillimit të një periudhe të re për rajonin e Ballkanit, që kërkonte stabilizim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Shqipëria mori ftesën për anëtarësim në samitin e Bukureshtit më 2 prill të vitit 2008. Më 25 prill të po të njëjtit vit Shqipëria filloi zyrtarisht bisedimet për anëtarësimin në NATO, që përfshinin disa çështje politike, ushtarake, sigurie dhe ligjore, ndërsa më 9 korrik të atij viti vendet anëtare të NATO-s nënshkruan në Bruksel protokollet e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Kroacinë. Më 1 prill 2009, Shqipëria u bë anëtare e plote e NATO-s, duke u bërë një nga anëtarët më të rinj të aleancës. Paraqitja e parë e Shqipërisë si anëtare me të drejta të plota e NATO-s u bë në Samitin e Aleancës që u mbajt në Strasbourg/Kehl më 4 prill 2009, ndërkohë që më 7 prill 2009, në selinë e Aleancës



në Bruksel, u zhvillua ceremonia zyrtare e ngritjes së flamujve të Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO.

KONTRIBUTI I SHQIPËRISË NË NATO:

Në këto 16 vite anëtarësimi, Shqipëria ka kontribuar aktivisht në misionet dhe operacionet paqeruajtëse të NATO-s, si dhe ka

luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit të rajonit të Ballkanit. Disa nga misionet ku Shqipëria ka marrë pjesë përfshijnë:

- *Misionet në Afganistan: Shqipëria ka kontribuar me trupa dhe ka ofruar mbështetje logjistike në misionet e NATO-s në Afganistan*
- *Misionet paqeruajtëse në*

Kosovë: Shqipëria ka kontribuar gjithashtu në misionin KFOR (Kosovo Force) të NATO-s, duke ofruar ndihmë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë.

- *Misionet në Libi dhe Irak: Trupa dhe përfaqësues të Shqipërisë kanë marrë pjesë edhe në misione të tjera të NATO-s në Lindjen e Mesme dhe Afrikë, si pjesë e angazhimit të përbashkët për sigurinë globale.*

Përveç angazhimeve ushtarake, Shqipëria ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave të sigurisë dhe bashkëpunimin me shtetet e tjera të NATO-s. Vendimi i Shqipërisë për të modernizuar ushtrinë dhe për të përmirësuar kapacitetet e saj mbrojtëse ka qenë një prioritet, dhe për këtë ka marrë mbështetje të vazhdueshme nga aleanca.

Reforma dhe Rritja e Kapaciteteve Ushtarake:

Një nga sfidat kryesore për Shqipërinë pas anëtarësimit në NATO ka qenë përmirësimi i kapaciteteve ushtarake dhe rritja e nivelit të gatishmërisë. Për të përmbushur standardet e NATO-s, Shqipëria ka bërë reforma të rëndësishme në sektorin e mbrojtjes, duke përfshirë modernizimin e ushtrisë, trajnimin e ushtarëve dhe përmirësimin e infrastrukturës ushtarake. Shqipëria ka investuar në teknologji moderne dhe ka rritur



bashkëpunimin me aleatët për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e operacioneve ushtarake.

Në përpjekje për të përmbushur standardet e NATO-s, Shqipëria ka kaluar në një periudhë të gjatë reformash, duke e reformuar më tej sistemin e mbrojtjes dhe duke forcuar lidhjet me shtetet e tjera anëtare. Kjo ka sjellë dhe rritje të besimit të aleatëve në angazhimin e Shqipërisë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit.

6 vite te anëtarësimit te Shqipërisë në NATO kanë shënuar një periudhë të rëndësishme për vendin, duke forcuar pozitat e tij në rajon dhe duke i dhënë mundësinë që të kontribuojë në sigurinë globale dhe të bëjë përparime të mëdha në sektorin e mbrojtjes dhe zhvillimit të brendshëm.

SHQIPËRI-NATO

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe NATO-s shënuan një stad të ri pas vendimit të Aleancës për të ndërtuar një bazë taktike ajrore në Shqipëri, që konsiderohet baza e parë ajrore e NATO-s në Ballk-

anin Perëndimor.

Më 4 mars 2024, në Kuçovë të Qarkut të Beratit u inaugurua Baza Ajrore Taktike e NATO-s, e vetmja bazë e Aleancës në rajon, që është konsiderua nga autoritetet shqiptare me një rëndësi të re gjeostrategjike për Shqipërinë.

Ndërkohë, autoritetet shqiptare kanë ftuar NATO-n që të marrë pjesë në një bashkëfinancim për pjesën ushtarake të Portit të Durrësit, për ngritjen e një baze të Aleancës në port.

Një aspekt tjetër i bashkëpunimit janë edhe operacionet dhe misionet paqeruajtëse. Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë angazhuar më parë dhe marrin pjesë në operacione ndërkombëtare dhe në misione të ndryshme jashtë vendit, si pjesë e operacioneve të drejtuara nga NATO, por edhe nga BE-ja dhe Kombet e Bashkuara (OKB).

Ushtarakët shqiptarë janë angazhuar në periudha të ndryshme në dhjetëra misione dhe operacione jashtë vendit, si në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë, Irak, Çad, Gjeorgji, në Detin Egje, Mali, Afganistan, Sudani i Jugut dhe Letoni. Shqipëria i ka kushtuar vëmendje edhe rritjes së buxhetit për mbrojtjen. Autoritetet shqiptare kanë deklaruar se viti 2025 parashikohet të jetë viti i dytë ku plotësohet angazhimi ndaj NATO-s për të arritur një buxhet mbi vlerën 2 për qind në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB).



76 vjet nga themelimi i NATO-s

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior, ose NATO, u krijua 76 vjet më parë dhe ka kaluar nëpër një proces evolucioni, duke u shndërruar në një aleancë të rëndësishme mbrojtjeje me 32 shtete anëtare në Evropë dhe Amerikën e Veriut.

Më 4 prill 1949 në Uashington, 12 vendet anëtare themeluese nënshkruan Traktatin e Atlantikut të Veriut: Belgjika, Kanada, Danimarka, Franca,

Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara.

Aleanca synonte të luftonte kundër kërcënimit sovjetik dhe bazohej në parimin e solidaritetit të ndërsjellë midis të gjithë anëtarëve të tij, siç përcaktohet në nenin 5: “Palët bien dakord që një sulm i armatosur kundër një ose më shumë prej tyre, në Evropë ose në Amerikën e Veriut, do të konsiderohet si një

sulm i drejtuar kundër të gjitha palëve”.

Gjatë viteve u bënë pjesë edhe Greqia, Turqia (1952), Gjermania (1955) dhe Spanja (1982). Pasi BRSS u shpërbë në vitin 1991, një fazë e re po krijohet për Aleancën dhe në maj 1997, NATO-ja dhe Rusia do të nënshkruanin “Aktin Themelues”.

1994: LUFTIMET E PARA NATO hapi zjarr për herë të parë më 28 shkurt 1994 duke

NATO's 76th Anniversary

With the aim of restructuring the security of Western Europe after World War II, NATO was established with the North Atlantic Treaty as a political and military alliance



“

Më 4 prill 1949 në Uashington, 12 vendet anëtare themeluese nënshkruan Traktatin e Atlantikut të Veriut: Belgjika, Kanada, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara.



gjuajtur katër avionë serbë në një zonë të ndaluar fluturimi të OKB-së në Bosnje-Hercegovinë. Më 16 dhjetor 1995, ajo zhvilloi operacionin e saj të parë në Bosnjë, ku shpërndau 60 000 trupa të forcave të IFOR-it.

Më 24 mars 1999, NATO nisi një fushatë bombardimi ajror për të ndalur shtypjen serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Kjo fushatë 78-ditore, pa mandatin e OKB-së, rezultoi me tërheqjen e serbëve nga provinca, që kaloi nën administrimin e OKB-së, një forcë e NATO-s (KFOR) prej 40 000 trupash të cilët do të ruanin paqen.

Parlamenti i Kosovës shpalli pavarësinë e kësaj ish-krahine serbe në shkurt të vitit 2008. Në vitin 1999, NATO mirëpriti vendet e para të Evropës ish-komuniste: Republikën Çeke, Në vitin 2001, pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vendi i parë që i drejtohen nenit 5. NATO më pas bashkohet me Uashingtonin në “luftën kundër terrorizmit”.

Si e tillë, në vitin 2003, Aleanca mori udhëheqjen e Forcës Ndërkombëtare të Ndhmës së Sigurisë në Afganistan (ISAF), mi-

sioni luftarak i cili do të zgjaste deri në vitin 2014.

Në mars 2004, shtatë vende të Evropës Lindore i bashkohen NATO-s: Sllovakia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania dhe tre ish-republikat sovjetike Lituania, Estonia, Letonia, anëtarësimi e të cilave veçanërisht irritoi Moskën. NATO-s iu bashkuan në vitin 2009 Shqipëria dhe Kroacia. Në vitin 2017, Mali i Zi bëhet anëtar i 29-të, tri vjet më vonë – 2020 pjesë e Aleancës u bë edhe Maqedonia e Veriut. Finlanda e Suedia janë vendet e fundit që iu bashkuan NATO-s më 2023, përkatësisht 2024, pavarësisht kundërshtimit të Rusisë.

Më 31 mars 2011, NATO mori komandën e ndërhyrjes perëndimore në Libi, e zbatuar nën një mandat të OKB-së në emër të mbrojtjes së civilëve. Operacioni “Unified Protector” prej 7 muajsh çon në përmbysjen e Muamar Gadafit.

NATO po ndihmon gjithashtu në parandalimin e piraterisë jashtë brigjeve të Afrikës dhe që nga viti 2016, ajo ka vendosur anijet e mbikëqyrjes për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore në Mesdhe.

Aleanca ndihmon gjithashtu anëtarët e saj për të forcuar mbrojtjen e tyre kibernetike.

Në vitin 2014, pas aneksimit të Krimesë nga Moska dhe veprimeve të Rusisë kundër Ukrainës, NATO pezulloi bashkëpunimin me Moskën.

Në vitin 2016, Aleanca vendos katër grupime shumëkombëshe taktike në Estoni, Letoni, Lituani dhe Poloni. Ky është përforsimi më i rëndësishëm i mbrojtjes kolektive që nga Lufta e Ftohtë.

Në nëntor 2018, NATO kreu manovrat më të madhe ushtarake që nga Lufta e Ftohtë në Norvegji, disa qindra kilometra larg kufirit rus.

NATO dënoi në termat më të ashpër të mundshëm agresionin ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës në shkurt 2022. Aleanca Veri-Atlantike vazhdon t'i ofrojnë Ukrainës nivele të paprecedentë mbështetjeje, duke ndihmuar në ruajtjen e së drejtës së saj themelore për vetëmbrojtje.

Sot Aleanca transatlantike është rritur nga 12 anëtarë themelues në 32 vende në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut, duke formësuar sigurinë globale për më shumë se shtatë dekada.

Trump njofton tarifa gjithëpërfshirëse globale, duke ndezur një luftë tregtare globale

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump njoftoi planet për tarifa gjithëpërfshirëse të mërkurën, duke thënë se SHBA-ja është “shkatërruar, plaçkitur, përdhunuar dhe grabitur” nga kombet afër dhe larg. Ai vendosi një tarifë prej 10 për qind për shumicën e mallrave të importuara në SHBA, por vendosi taksa shumë më të larta për miqtë dhe armiqtë, duke nxitur një luftë tregtare globale që mund të nxisë inflacionin dhe të pengojë rritjen.



Presidenti i SHBA Donald Trump intensifikoi një luftë tregtare globale të mërkurën, ndërsa vendosi tarifa gjithëpërfshirëse mbi importet nga aleatët dhe armiqtë njësoj, duke i çuar tregjet në një kthesë dhe duke ndryshuar normat e tregtisë së lirë prej dekadash.

BE-ja dhe Kina u zotuan të hakmerren kundër taksave, me liderin e Australisë që tha se tarifat e reja nuk ishin “veprim i një miku” dhe do të dëmtonin marrëdhëniet e aleatëve të ngushtë.

Menjëherë pas shpalljes së Trump, tarifat e veçanta prej 25 për qind për të gjitha makinat e prodhimit të huaj dhe kamionët e lehtë hynë në fuqi, me pjesët e automjeteve që gjithashtu do të vendosen deri më 3 maj.

Duke mbajtur një tabelë të masave gjithëpërfshirëse në Kopshtin e Trëndafilave të Shtëpisë së Bard-

hë, Trump zbuloi tarifa veçanërisht shtrënguese ndaj partnerëve kryesorë tregtarë Kinën dhe Bashkimin Evropian në atë që ai e quajti “Dita e Çlirimit”.

“Kjo është një nga ditët më të rëndësishme, për mendimin tim, në historinë amerikane”, tha Trump. “Është shpallja jonë e pavarësisë ekonomike”.

Njoftimi i tarifave shkaktoi zemërim të menjëhershëm në mbarë botën, me rivalin e Kinës që paralajmëroi se ato mund të “rrezikojnë” zhvillimin ekonomik global.

Tregjet e aksioneve dukeshin të vendosura për paqëndrueshmëri të madhe të enjten, me Nikkei i Tokios që kryeson një shitje aziatike, duke u rrëzuar me më shumë se 4 për qind dhe aksionet e Hanoi ranë më shumë se 5 për qind pasi Vietnami u caktua me tarifa prej 46 për qind.

Kontratat e së ardhmes në SHBA ranë dhe ari i sigurt shënoi një rekord të ri pasi investorët u frikësuan.

Trump rezervoi disa nga goditjet më të rënda për ato që ai i quajti “kombet që na trajtojnë keq”.

Kjo përfshinte një shtesë prej 34 përqind për mallrat nga Kina – duke e çuar tarifën e re të shtuar atje në 54 përqind.

Pekini u zotua me shpejtësi kundërmasave dhe bëri thirrje për dialog, duke paralajmëruar se taksat do të “dëmtonin seriozisht” personat e përfshirë.

Shifra për Bashkimin Evropian ishte 20 për qind dhe 24 për qind për Japoninë, ministri i tregtisë së cilës i quajti tarifat “jashtëzakonisht për të ardhur keq”.

Për pjesën tjetër, Trump tha se do të vendoste një tarifë “bazë” prej 10 përqind, duke përfshirë një tjetër aleat kyç, Britaninë.

Republikani 78-vjeçar e hodhi poshtë frikën nga trazirat, duke insistuar se tarifatat do të rikthenin ekonominë e SHBA-së në një “Epokë të Artë” të humbur.

“Për dekada, vendi ynë është plaçkitur, shkatërruar, përdhunuar dhe grabitur nga kombet afër dhe larg, si miq ashtu edhe armiq,” tha Trump.

“Bëni Amerikën përsëri të pasur”

Një audiencë e zgjedhur me dorë e anëtarëve të kabinetit, si dhe punëtorë me kapele të forta nga industritë përfshirë çelikut, naftën dhe gazin, brohoritnin ndërsa Trump premtoi se tarifatat do ta “bënin Amerikën përsëri të pasur”.

Trump i etiketoi tarifatat e së mërkurës si “reciproke”, por shumë ekspertë thonë se vlerësimet e administratës së tij për taksat e vendosura mbi importet amerikane nga vendet e tjera janë jashtëzakonisht të ekzagjeruara.

Presidenti i SHBA-së e kishte telegrafuar këtë masë për javë të tëra, duke shkaktuar frikën e një recesionit në vend pasi kostot u kalohen konsumatorëve amerikanë dhe një luftë të dëmshme tregtare jashtë vendit.

Sekretari amerikan i Thesarit Scott Bessent paralajmëroi kundër kundërmasave, duke thënë në Fox News: “Nëse hakmerreni, do të ketë përshkallëzim”.

Disa nga partnerët tregtarë të goditur më keq ishin në Azi, duke përfshirë 49 për qind për Kamboxhian, 46 për qind për Vietnamin dhe 44 për qind për Myanmarin e sunduar nga ushtria, i goditur së fundmi nga një tërmet shkatërrues.

Rusia nuk u ndikua sepse ajo tashmë po përballet me sanksione për luftën në Ukrainë “të cilat përjashtojnë çdo tregti kuptimplotë”, tha një zyrtar i



Shtëpisë së Bardhë.

Disa mallra si bakri, farmaceutikët, gjysmëpërçuesit, druri dhe ari nuk do t'i nënshtrohen tarifave, sipas Shtëpisë së Bardhë.

‘LUFTA’

Shefja e BE-së Ursula von der Leyen u zotua se Evropa ishte “e përgatitur për t’iu përgjigjur” tarifave, duke i quajtur ato një “goditje të madhe për ekonominë botërore”.

Kryeministrja italiane Giorgia Meloni, një aleate e ngushtë e Trump, tha se taksat ndaj BE-së ishin “të gabuara”, por u zotua të kërkonte një marrëveshje.

Britania shpëtoi relativisht lehtë pas një ofensive diplomatike, por tha se ende dëshironte të “zbusë” tarifatat.

Kanadaja dhe Meksika nuk preken nga taksat e reja pasi Trump i ka ndëshkuar tashmë për atë që ai thotë se është dështimi i tyre për të penguar trafikun e drogës dhe imigrimin e paligjshëm.

Kryeministri kanadez Mark Carney u zotua të “luftojë” taksat ekzistuese.

